

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “NB POWER” SH.P.K.**

Sot më datë 02 Prill 2025, ne themeluesit:

- **Z. Bledar Qira**, i datëlindjes 27.11.1983, banues në Tiranë, dhe

- **Shoqëria “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k** me seli qendrore në Rruga Tirana, Objekti Prime Group, C4/3, Llamella D Kati II, Nr.4, në Prishtinë me NIPT 810860272, përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues Admir Bytyçi

shprehin vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **“NB Power” sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria **“NB Power” sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortakët:

- 1- Z. Bledar Qira
- 2- Shoqëria “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“NB Power” sh.p.k.** do të jetë:

Studim, projektim, instalim, ndërtim, mbikëqyrje dhe kolaudim:

- impiantesh të prodhimit të energjisë elektrike nga dielli, era, uji, burimet termike, sisteme të ruajtjes/akumulimit të energjisë elektrike (storage station), burimet gjeotermale, biogazi, nafta dhe qymyri, për shoqërinë ose për të tretët, etj;

- nënstacionesh elektrikë, primar, sekondar, kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës dhe transformatorëve, linjave elektrike të tensionit të lartë, të mesëm dhe të ulet, ajrorë, kablllore, etj, për transmetim dhe shpërndarje të energjisë elektrike;



- linjash dhe impiantesh të brendshme dhe të jashtme elektrike, telefonisë, radiotelefonisë, TV-ve etj, për objekte civile dhe industriale, linjave të telefonisë dhe telekomunikacionit, impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, etj;

- instalimesh hidrosanitare, termoteknike, sistemeve të ventilimit, sistemeve të kondicionimit, sistemeve të furnizimit me gaz, etj;

Auditim energjetik i ndërtesave civile, publike dhe jopublike, auditimi i ndërtesave dhe instalimeve industriale, si dhe certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave dhe instalimeve industriale; Menaxhim të energjisë; Hartimi i Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, studime mjedisore, kryerja e monitorimeve dhe auditimeve mjedisore, hartimi i ekspertizave për probleme mjedisore, dhënie konsulence për çështje mjedisore etj; Prodhimi, furnizimi dhe tregtimi i energjisë elektrike.

Import-eksport dhe tregtim mallrave në fushën e energjisë, që përdoren për ndërtimin, mirëmbajtjen, menaxhimin, kolaudimin dhe mbikqyrjen e centraleve, sistemeve, rrjeteve, nënstacioneve, linjave elektrike, sistemeve të ruajtjes/akumulimit të energjisë elektrike (storage station), impjanteve fotovoltaike, termodinamike e formave të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme primare si: hidrike, diellore, me ere, biomasa, etj;

Konsulence dhe ndërmjetësim për financime dhe marrëveshje shit-blerje energjie (PPA) në sektorin e energjisë; Zbatim projektesh, ndërtim, mirëmbajtje, operim dhe shfrytëzim objektsh të sistemit elektroenergjetik.

Përfaqësimi i shoqërive të huaja sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim; Ofrimi i ndërmjetësimit, konsulencës, studimit të tregut dhe këshillimit për pasuritë e paluajtshme, vlerësim i pasurive të paluajtshme, etj. Konsulencë ligjore, teknike, ekonomike në çdo aktivitet që lidhet me fushën e energjisë, efikasitetin e energjisë, mjedisit, pasurive të paluajtshme, etj;

Akt ekspertiza, vlerësime, analiza në sektorin elektroenergjetik. Projekte për mbrojtjen nga zjarri. Mësimdhënie dhe trajnime në fushën elektroenergjetike. Sigurimi dhe ri sigurimi të jo jetës në përputhje me legjislacionin Shqiptar. veprimtarinë e sigurimit.

Sherbime për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mbrojtjen kundër zjarrit. Përgatitje dhe hartim të dokumenteve të vlerësimit të rrezikut. Sherbime të lidhura me fushat e mesipërme si edhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohej nga ligji.



4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “NB Power” sh.p.k. do të jetë në: Rruga "Jorgo Plaku", Nd.20, Hyrja 1, Ap.10, Njësia Bashkiake Nr.4, Tiranë.

4.1 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “NB Power” sh.p.k. është 100.000 Lekë. (njëqindmijë)

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë vijon:

1. Ortaku themelues Z. Bledar Qira, zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 51.000 Lekë që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë;
2. Ortaku themelues shoqëria “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k, zotëruese e 1 kuote me vlerë të përgjithshme 49.000 Lekë që përbën 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “NB Power” sh.p.k. është **Z. Bledar Qira**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

 3

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “NB Power” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku

Bledar Qira



“FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k

Ortaku

Admir Bytyçi

Admir Bytyçi

